



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

16 Dhjetor 2015



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Nxënësit e shkollave në Tetovë protestuan kundër ndotjes së ajrit



Nxënësit e shkollave të mesme në Tetovë sot protestuan kundër ndotjes së ajrit .Tetova mbrëmë arriti majat më të larta sa i përket ndotjes 996 Pm ku helmi arriti të hyjë në shtëpi dhe banesa të tetovarëve.

Gjithashtu sot shumë nxënës bojkotuan mësimin për shkak të ajrit të ndotur pas thirrjes nga ana Lëvizjes “Nëna dhe Fëmija” për të bojkotuar mësimin në shkollat e Tetovës.

Ndryshe ditën e Enjte është paralajmëruar bllokimi i rrugëve nga Eco Guerilla dhe të Premten protestë masive./tetovasot

Të enjten do të bllokohen rrugët e Tetovës, të premtën protestë masovike



Ashtu siç edhe u paralajmërua për protestën e radhës për ajrin e ndotur në Tetovë, lëvizja Eco Guerilla, ora 13 te oborri i shkollës fillore ‘Liria’, mbajti një fjalim të shkurtër, njofton Telegrafi.

Arianit Xhaferi nga Eco Guerilla u bëri thirrje qytetarëve për mobilizim masiv rreth protestës ku edhe njoftoi për ditën e protestës. Xhaferi potencoi ‘nga dita e enjte nga ora 12 me bllokim të rrugëve, kurse të premtën pritet protestë masive.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Rajoni i Tetovës arrin kulmin e ndotjes, grimcat PM 10 shkojnë në 996



Niveli i ndotjes së ajrit në rajonin e Pollogut ka kaluar çdo kufi të së lejuarës. Grimcat PM10 kanë mbërritur në 996, duke kaluar rreth 20 herë masën e lejuar, që parashihet edhe me konventën Evropiane. Ndotja enorme ka alarmuar organizatat e ndryshme, të cilat kanë ngritur zërin për marrjen e masave urgjente. Shoqata Nëna dhe Fëmija dhe Eko Guerilla bënë thirrje për bojkotimin e mësimin, duke mos lejuar fëmijët të shkojnë nëpër shkollë përderisa ndotja është në nivel kaq të madh. Janë paralajmëruar masa edhe më radikale, siç janë protestat dhe bllokimi i rrugëve.

“Fëmijët tanë nuk do marrin pjesë në mësim për ditën që do shohim se do jenë të ndotura në nivel alarmant”, tha Arta Kasa, Shoqata Nëna dhe Fëmija.

“Është koha të bëhemi bashkë pozitë opozitë krejt nacionalitetet, nuk është pyetja më a do sëmuremi por, kur do sëmuremi. Do nisim ti bllokojmë rrugët ti bllokojmë institucionet sepse vërtetë kemi nevojë për një zgjidhje. Të enjten në ora 12, në udhëkryqin e Ilindenit me shkollën mjekësore do bllokohen rrugët prej 12 deri në ora një, dhe në udhëkryqin tek rrethi tek veroja do bllokohet në të njëjtën kohë”, u shpreh Elmedina Abdullahi, Shoqata Nëna dhe Fëmija.

“Qytetarët e Tetovës nuk duhet të presin të vij dikush tjetër t`ua zgjidh këto halle, nëse nuk do gjejnë kohë gjatë këtyre ditëve të dalin dhe të ngrenë zërin atëherë do gjejnë kohë të vrapojnë dyerve të onkologjisë dhe radiologjisë për të shëruar kancerin e vet ose të fëmijëve të tyre mos dhashë Zoti”, deklaroi Arianit Xhaferi, EkoGuerilla.

Nga ana tjetër, aktivistët e Qendrës për Bashkëpunim Ballkanik Loja, nëpër pemët e qytetit, ka vendosur maska dhe kavanoz me mbishkrimin, “stacion për thithje të ajrit të pastër”, aktivitet ky përmes të të cilit duan sensibilizojnë opinionin për ndotjen.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



“Fatkeqësisht ndodhi edhe helmimi i mbrëmshëm dhe u bashkuan të dy aktivitetet që është si revoltë e vullnetarëve dhe gjithë qytetarëve kundër ndotjes së ajrit”, theksoi Gëzim Osmani, “LOJA”.

Edhe pse ndotja e ajrit mbrëmjen e kaluar arriti kulmin, institucionet nuk kanë bërë kurrfarë reagimi. Organizatat joqeveritare kanë akuzuar se institucionet si lokale ashtu dhe ato qendrore, vazhdojnë të mbyllin sytë para helmimit masiv që ndodh në qytetin e Tetovës.